



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.1613/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Omega” SH.P.K., me seli në Pejë, të cilin e përfaqëson Lulzim Balaj avokat nga Peja, kundër debitorit “Kosova Tourist” me seli në Podujevë, me bazë juridike përmbarimore pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e autorizuarit të kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.106/2023 të datës 05.10.2023, me datë 20.03.2024. mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e kreditorit “Omega” SH.P.K., me seli në Pejë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.106/2023 i datës 05.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.106/2023 të datës 05.10.2023, ka aprovuar prapësimin e debitorit “Kosova Tourist”, ashtu që ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.281/2020 të datës 10.06.2020, të lëshuar nga përmbauesi privat Jeton Krasniqi dhe ka përfunduar në tërësi procedurën në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa, ashtu që aktvendimi i ankimuar të prishet dhe ta detyroj debitorin në pagimin e borxhit apo çështja të kthehet në rigjykim.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e autorizuarit të kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Omega” SH.P.K., me seli në Pejë, më datë 05.06.2020 ka paraqitur propozim për përmbarrim, kundër debitorit “Kosova Tourist” me seli në Podujevë, në bazë të dokumenti të besueshëm – faturës nr.40/16 dt.01.02.2016, nr.92/16 dt.26.02.2016, nr.174/16 dt.13.04.2016, nr.182/16 dt.16.04.2016, nr.258/16 dt.23.05.2016, në shumën e përgjithshme prej 1,860.00 Euro.

Përmbarruesi privat Jeton Krasniqi, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit me urdhrin P.nr.281/2020 të datës 10.06.2020, ka lejuar përmbarrimin kundër debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm i plotëson kushtet për përmbarrim.

Kundër këtij urdhri përmbarrimor debitorit me datë 14.08.2020 ka paraqitur prapësim, duke e kundërshtuar urdhrin përmbarrimor, me arsyetimin se propozimi për përmbarrim është i paqartë, i pakuptueshëm dhe nuk dihet se çfarë kërkohet, kush është kreditor. Urdhri i lejuar përmban shkelje të dipozitive ligjore sepse ekzistojnë kundërthënie mes dispozitivit dhe shkresave në lëndë, përmban vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ngase objekti i propozimit është përmbushje e tërësishme e obligimit, pa specifikuar kur është krijuar ky detyrim, me cilën periudhë kohore për çfarë raporti juridiko civil, po ashtu shuma e pretenduar prej 1,860.00 euro nuk qëndron në asnjë mënyrë sepse kreditori nuk ia ka bashkangjitur asnjë kupon fiskal që është obligim kur një send shitet dhe nga shuma të paguhet tatimi. Ka shtuar se nuk kemi asnjë borxh ndaj kreditorit, faturës kreditori nuk ia ka bashkangjitur asnjë provë relevante për të pasur cilësinë e dokumentit të besueshëm. Andaj, ka propozuar që të aprovohet prapësimi dhe të anulohet urdhri për përmbarrim.

Përgjigje në prapësimin ka paraqitur kreditori me datë 18.08.2020, me arsyetimin se në këtë rast kemi të bëjmë me dokumente të besueshëm, nga kartelat e konsumatorit shihet qartë se borxhi i debitorit është bartur nga viti në vit. Andaj, ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar dhe urdhri për përmbarrim të vërtetohet ashtu që procedura të vazhdoj.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.94/2020 të datës 12.11.2020, me të cilin ka aprovuar prapësimin e debitorit si të bazuar, ka shfuqizuar urdhrin përmbarrimor P.nr.281/20 të datës 10.06.2020 dhe ka hedh poshtë si të palejuar propozimin për përmbarrim të kreditorit "Omega" SHPK nga Peja. Me arsyetimin se duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare nëse është në zhvillim e sipër gjykimi tjetër për të njëjtën çështje, për të njëjtën kërkesëpadi midis palëve të njëjta, gjeti se në këtë çështje përmbarrimore të ngritur sipas propozimit të kreditorit është gjykuar dhe përfunduar me aktvendim të kësaj gjykate PPP.nr.281/2019 dt.21.02.2020, i cili si i tillë është i formës së prerë me të cilin është zgjidhur çështja përmbarrimore ndërmjet palëve ndërgjyqëse dhe kjo çështje tani është jolëndore e gjykuar (res judicata). Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së

Dytë duke vendosur në procedurën ankimore sipas ankesës së palës kreditore, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 723/2022 të datës 15.12.2022 ka aprovuar si të bazuar ankesën e kreditorit dhe ka anuluar në tërësi aktvendimin PPP.nr.94/2020 të datës 12.11.2020 dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje.

Në procedurën e rishqyrtimit, Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Parë pas vlerësimit të provave të administruara ka marr aktvendimin KPPP.nr.106/2023 të datës 05.10.2023, me të cilin ka aprovuar prapësimin e debitorit “Kosova Tourist”, ashtu që ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.281/2020 të datës 10.06.2020, të lëshuar nga përmbartuesi privat Jeton Krasniqi dhe ka përfunduar në tërësi procedurën në këtë çështje përmbartimore, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në ri procedurë pas vlerësimit të prapësimin, përgjigjes në prapësim, shkresave të lëndës dhe duke ka marr për bazë sugjerimet e gjykatës së shkallës së dytë, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkak se dokumentet e besueshme - fatura nr.40/16 është bërë e arritshme me datë 01.02.2016, fatura nr.92/16 është bërë e arritshme me datë 26.02.2016, fatura nr. 174/16 është bërë e arritshme lëshuar me datë 13.04.2016, fatura nr. 182/16 është bërë e arritshme me datë 16.04.2016, dhe fatura nr.258/16 është bërë e arritshme me datë 23.05.2016, ndërsa propozimi për përmbartim në raport me këto fatura është paraqitur me datë 05.06.2020, mbi tre (3) vite nga arritja për pagesë e secilës prej tyre. Ku rezulton se realizimi i tyre përmes procedurës përmbartimore është kërkuar pas kalimit të afatit të paraparë me dispozitën e nenit 355 të LMD-së. Tutje gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se ka vlerësuar pagesat e datës 01.04.2017 në vlerë prej 500.00 euro dhe datës 21.04.2017 në vlerë prej 100.00 euro të cilat i ka prezantuar kreditori përgjatë seancën dëgjimore, por që nga koha kur janë ekzekutuar pagesat e lartcekura nga debitori, e deri në inicimin e procedurës përmbartimore me datë 05.06.2020 përsëri kanë kaluar mbi tre (3) vite. Në këtë drejtim, referuar nenit 373 të LMD-së me të cilin parashihet se “Pas ndërprerjes parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri, kurse koha që ka kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim. 2. Parashkrimi i ndërprerë me anë të pranimit (pohimit) nga ana e debitorit fillon të rrjedhë përsëri nga pranimi (pohimi)”, rezulton se përkundër faktit se pagesat e lartcekura kanë shkaktuar ndërprerjen e afatit të parashkrimit, borxhi që buron nga faturat objekt i këtij përmbartimi ka arritur parashkrimin përsëri, kjo pasi që nga pagesa e fundit e datës 21.04.2017 e deri në paraqitjen e propozimit të ri për përmbartim me datë 05.06.2020, përsëri kanë kaluar mbi tre (3) vite.

Dhoma e Shkalles e Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton edhe sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata ankimore vlerëson se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar ka konstatuar drejt faktin se faturat: nr.40/16 dt.01.02.2016, nr.92/16 dt.26.02.2016, nr.174/16 dt.13.04.2016, nr.182/16 dt.16.04.2016, nr.258/16 dt.23.05.2016, në bazë të cilave organi përmbarues ka caktuar përmbarimin janë fatura në të cilat borxhi i paraparë i debitorit për pagesë për shumën prej 1,860.00 Euro është parashkruar dhe kjo bazuar në nenin 355 paragrafi 1 të LMD-së, ku shprehimisht theksohet se: *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite”*. Ndërsa me paragrafin 2 të të njëjtit nen, përcaktohet: *“Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”*, e që në rastin konkret kreditori propozimin për përmbarim e ka ushtruar me datë 05.06.2020 ndërsa faturat janë te vitit 2016, pra në një diferencë kohore për më shumë se tre vite.

Gjykata ankimore ka vlerësuar pretendimet e autorizuarit të kreditorit lidhur me ndërprerjen e parashkrimit meqë debitori kishte kryer pages në shumën prej 500.00 Euro me datë 04.01.2017 dhe në shumën prej 100.00 Euro me datë 25.04.2017, gjeti se këto pagesa vërtetohen nga pasqyra bankare, mirëpo te qarkullimi bankar nuk ishte shënuar përshkrimi se cilat fatura ishin paguar, por vetëm përshkrimi i përgjithësuar (pagesa për pjesë dhe pagesë për vajra motorike), pa veçuar se për cilat fatura ishte bërë pagesa. Gjithashtu gjykata analizoj faturat mbi bazën e të cilave kërkohet realizimi i borxhit, konstatoj se për secilin faturë veç e veç afati parashkrimit llogaritet me arritjen e tyre për pagës, andaj nga kjo gjendje e vërtetuar faktike gjykata konstaton se të gjitha faturat kanë arritur afatin e parashkrimit duke llogaritur edhe afatin e arritjes për pagës

Andaj, gjykata ankimore vlerëson se pretendimet e autorizuarit të kreditorit janë te pabazuara dhe irelevante për një vendosje ndryshe, të cilat edhe i refuzoi si të tilla.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së dytë
K.Dh.Sh.II.nr.1613/2023 me datë 20.03.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha